



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
ZV.REKTORI PËR SHKENCËN DHE PROJEKTET

Thirrje për projektpropozime për

Bashkëpunim në kërkime shkencore brenda/ndërmjet njësive bazë

Thirrja për dorëzimin e propozimeve

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, shpall thirrjen **për projektpropozime me synim krijimin e rrjeteve shkencore dhe bashkëpunimin e studiuesve brenda njësive bazë ose mes njësive të ndryshme akademike me vëmendje të veçantë përfshirjen në propozime edhe të veprimtarive me pjesëmarrje studentore**. Thirrja është pjesë e ndërmarrjes së UNIKO për mbështjetjen e veprimtarive kërkimore-shkencore, e financuar nga fondet e paracaktuara në buxhetin e Universitetit për projektet shkencore.

Afati i fundit për aplikim: 30 maj 2018

Financimi i përgjithshëm në dispozicion për këtë thirrje është 1 000.000. AL. Financimi është i parashikuar për një kohëzgjatje maksimale prej 12 muajsh dhe duhet të justifikohet nga përmbajtja, ngarkesa e punës, kohëzgjatja dhe numri i ekipeve të përfshira. Për projektet me kosto më të larta financiare se buxheti i parashikuar, pritet bashkëfinancim nga burime të tjera të brendshme ose të jashtme.

Veprimtaritë e mundshme të projektit janë: studime krahasuese, kërkime të vogla empirike, planifikime dhe këmbim i metodës me standardet dhe praktikatat evropiane në fushat e zgjedhura kërkimore, rritja e kapaciteteve infrastrukturore etj.

Koordinatori i projektit duhet të jetë specialist i fushës për të cilën hartohet projekti.

Përbërja formale e detyrueshme e grupit të punës duhet të përfshijë së paku katër persona. Grupi i punës mund të përfshijë në përbërje edhe studentë.

Të gjitha njësitë bazë të UNIKO janë të ftuara të paraqitin projektpropozimet e tyre.

Propozimet duhet të kontribuojnë në bashkëpunimin e rëndësishëm shkencor brenda departamentit ose njësive kryesore të UNIKO. Shkalla dhe cilësia e përfshirjes së bashkëpunimit janë kritere të rëndësishme për vlerësimin.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është **30 maj 2018**. Të gjitha veprimtaritë e projektit duhet të përfundojnë brenda kohëzgjatjes së projektit (maks. 12 muaj).

Aplikuesit mund të zgjedhin si datë fillestare të projektit:

- 1) Projekti fillon më 30 qershor 2018 dhe përfundon më 30 maj 2019
- 2) Projekti fillon më 1 shtator 2018 dhe përfundon më 30 gusht 2019

Fushat tematike

Projektet e financuara në këtë thirrje duhet t'u japin përparësi fushave parësore të kërkimit të përcaktuara nga njësia bazë UNIKO, prej së cilës vjen propozimi:

Afati kohor:

Hapja për thirrje për propozime	2 maj 2018	
Afati i fundit për dorëzim	30 maj 2018	
(Rekomandohet që propozimi të dërgohet në formatin elektronik dhe shkresor)		
Propozimi duhet të dërgohet në formë elektronike në e.papa@unkorce.edu.al Koordinatori do të marrë një konfirmim elektronik (nga e-mail-adresa e propozimit) brenda 2 ditëve pas afatit të fundit për aplikim.		
Vlerësimi i propozimeve	14 qershor 2018	
Takimi i bordit përzgjedhës	15 qershor 2018	
Dhënia e kontratave të projektit	qershor / shtator 2018	
	<i>Varianti 1</i>	<i>Varianti 2</i>
Data e fillimit të projektit	30 qershor 2018	1 shtator 2018
Raporti i përkohshëm	31 janar 2019	30 mars 2019
Raporti final dhe përfundimi i projektit	31 maj 2019	31 gusht 2019

E drejta për pjesëmarrje

Të drejtën për aplikim e kanë **vetëm njësitë bazë të UNIKO, si dhe Këshilli studentor**. UNIKO ruan të drejtën e kontrollit të herëpashershëm sipas parashikimeve të bëra edhe më lart.

Kriteret për vlerësimin e propozimeve

Kriteret që do të zbatohen në vlerësimin e projekteve janë si më poshtë:

- Natyra e veprimtarisë së propozuar (objektiva të qarta, rëndësia shkencore dhe e cilësisë, realizueshmëria, përfitimi i mundshëm, ndikimi, qëndrueshmëria, orari i përshtatshëm koha dhe rrjedha e punës) (40%);
- Shkalla dhe cilësia e bashkëpunimit brenda/ndërmjet njësive akademike (10%);
- Kualifikimi dhe ekspertiza e koordinatorit dhe anëtarëve të projektit (15%);
- Kostoja dhe vlera e veprimtarive, buxheti transparent, justifikimet e buxhetit (20%);
- Koncepti dhe mënyra e përfshirjes, ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i studiuësve të rinj të UNIKO (10%);

- Shqyrtimi i fushave tematike (5%).

Propozuesit inkurajohen të mbështesin veprimtari ndërdisiplinore dhe bashkëpunim brenda/ndërmjet njësive. Me qëllim rritjen e përfaqësimit studentor, do të favorizohen propozimet me më tepër pjesëmarrje nga ky grup, në rastet kur rankimi i propozimeve është i barabartë.